

# 30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVIZIONE



Fq. 2

**Krasniqi pret bashkë-raportuesit e Asamblesë Parlamentare të KiE: Në fokus reformat në median audiovizive**

**Transparenca AMA-TikTok: Hiqen 24 materiale me përmbajtje të dëmshme dhe 1,087 foto/video pirate nga platforma**



Fq. 2

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X



Fq. 2


**Përmirësimi i kushteve të punës në media, AMA dhe Inspektorati i Punës në tryezën e radhës. Diskutohen rezultatet e inspektimeve dhe sfidat e tregut**

**Kryetarja e AMA-s në Dialogun Parlamentar të organizuar nga KiE në Kuvend: Lufta kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes prioritet i AMA-s**

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi ishte pjesë e tryezës së mbledhur...



Fq. 2



Fq. 2

**Forcimi i bashkëpunimit institucional, kryetarja Krasniqi takon Avokatin e Popullit, Endrit Shabani**

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), Znj. Armela Krasniqi, zhvilloi një takim pune me Avokatin e Popullit, Z. Endrit Shabani, ku në fokus ishte forcimi...

## Krasniqi pret bashkë-raportuesit e Asamblesë Parlamentare të KiE: Në fokus reformat në median audiovizive

Kryetarja e AMA-s, Znj. Krasniqi zhvilloi një takim me delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (KiE). Gjatë takimit u diskutua mbi veprimtarinë e AMA-s si institucion i pavarur rregullator në fushën e medias audio dhe audiovizive, si dhe mbi zhvillimet dhe sfidat e realitetit mediatik në vend. Një vëmendje e veçantë iu kushtua procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me aktet kryesore europiane, përfshirë Aktin European për Lirinë e Medias (EMFA) dhe Aktin për Shërbimet Digjitale (DSA). [Lexo më shumë](#)



## Transparenca AMA-TikTok: Hiqen 24 materiale me përmbajtje të dëmshme dhe 1,087 foto/video pirate nga platforma

Falë bashkëpunimit mes AMA-s, qytetarëve dhe platformës TikTok për trajtimin e përmbajtjeve të dëmshme online, në funksion të forcimit të sigurisë digjitale dhe zbatimit të ligjit, janë hequr nga platforma 24 materiale me përmbajtje të dëmshme dhe 1,087 foto/video pirate. Nga momenti i rihapjes së platformës TikTok deri më sot, AMA ka shqyrtuar gjithsej 153 ankesa të ardhura nga qytetarët. [Lexo më shumë](#)



## Përmirësimi i kushteve të punës në media, AMA dhe Inspektorati i Punës në tryezën e radhës. Diskutohen rezultatet e inspektimeve dhe sfidat e tregut

Në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit dhe planit të përbashkët të punës, Kryetarja e AMA-s zhvilloi një takim pune me Drejtorin e Përgjithshëm të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Z. Eljo Muçaj, për të diskutuar mbi ecurinë e bashkëpunimit ndër-institucional dhe prioritetet e përbashkëta për periudhën në vijim. Në fokus të takimit ishin progresi në zbatimin e objektivave të përbashkëta, situata në sektorin e medias për vitin 2025 dhe tremujorin e parë të 2026-s dhe prioritetet për periudhën në vijim. [Lexo më shumë](#)

## Kryetarja e AMA-s në Dialogun Parlamentar të organizuar nga KiE në Kuvend: Lufta kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes prioritet i AMA-s



Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi ishte pjesë e tryezës së mbledhur në Kuvendin e Shqipërisë me temë "Forcimi i kuadrit ligjor të Shqipërisë kundër racizmit dhe gjuhës së urrejtjes: Dialog parlamentar për përafrimin me standardet europiane", e organizuar nga Këshilli i Europës. Kjo tryezë u organizua në kuadër të programit të përbashkët BE/KiE, "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë". [Lexo më shumë](#)

[Lexo më shumë](#)



## Forcimi i bashkëpunimit institucional, kryetarja Krasniqi takon Avokatin e Popullit, Endrit Shabani



Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), Znj. Armela Krasniqi, zhvilloi një takim pune me Avokatin e Popullit, Z. Endrit Shabani, ku në fokus ishte forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit institucional. Gjatë takimit, palët diskutuan mbi zgjerimin e bashkëpunimit dhe mundësinë e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen e afërt, me synim rritjen e efektivitetit në adresimin e çështjeve me interes publik. [Lexo më shumë](#)

[Lexo më shumë](#)

## Studimi i parë kombëtar nga Këshilli i Ankesave dhe INSTAT për “Besueshmërinë e Medias dhe Rolin e Gazetarisë në Shqipëri”, 72.5% e të anketuarve e vlerësojnë pozitivisht

Për herë të parë, Këshilli i Ankesave në Autoritetin e Mediave Audiovizive, në bashkëpunim me INSTAT, ka realizuar një studim kombëtar që hedh dritë mbi besueshmërinë e medias dhe perceptimin e publikut për rolin e gazetarisë në shoqëri. Një nga gjetjet kryesore të këtij studimi është se 72.5% e të anketuarve e konsiderojnë profesionin e gazetarit si të vlerësuar në shoqëri. Ky perceptim e vendos gazetarinë si një profesion me funksion thelbësor në jetën demokratike, duke kontribuar në informimin e publikut, rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e interesit publik.

[Lexo më shumë](#)



## AMA dhe CRCA forcojnë partneritetin për sigurinë e fëmijëve dhe adoleshentëve në mjedisin digjital

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, priti kreun e CRCA-së (Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri) në kuadër të forcimit të bashkëpunimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve në mjedisin digjital. Gjatë takimit, Znj. Krasniqi theksoi se siguria e fëmijëve në hapësirën online mbetet një nga prioritetet kryesore të AMA-s, në funksion të ndërtimit të një mjedisi mediatik më të sigurt, më të përgjegjshëm dhe më mbrojtës për grupmoshat më të ndjeshme.

[Lexo më shumë](#)

